

Material konsultimi për raportimin e qëndrueshmërisë

Konsultimet



- Pjesë e shqyrtimit të strategjisë pesëvjeçare të administratorëve të besuar
- Fokus i përsheptuar te qëndrueshmëria
- Puna kërkimore, analiza & angazhimi fillestar nga task-forca e administratorëve të besuar
- Nën orientimet e grupit këshillimor të ekspertëve
- Bazuar në kërkesë
- Çështje të nivelit të lartë dhe specifike
- Kërkesat kryesore për suksesin

Raportimi i qëndrueshmërisë vlerësimi i situatës aktuale



Kërkesë e ngutshme në rritje



Ana e ofertës në tranzicion



Nevoja për njëtrajtshmëri në raportim dhe për informacione të krahasueshme

Opsionet e nivelit të lartë të marra në konsideratë

- 1. Mbajtja e status kuosë**
- 2. Lehtësimi i nismave ekzistuese**
- 3. Krijimi i një Bordi të Standardeve të Qëndrueshmërisë (BSQ)**
 - Brenda strukturave të Fondacionit të SNRF-ve
 - Krahas BSNK-së
 - Mbështetur në punën e shkëlqyer të nismave ekzistuese për qëndrueshmërinë

Kërkesat për suksesin e BSQ-së


- Të arriturit e mbështetjes së mjaftueshme globale
- Të punuarit me nismat rajonale
- Të siguruarit e mjaftueshmërisë së strukturave të drejtimit të brendshëm
- Të arriturit e ekspertizës së duhur teknike
- Të arriturit e nivelit të financimit të nevojshëm më vete
- Bashkimi efektiv i forcave me raportimin financiar
- Të treguarit kujdes që të mos cenohen misioni dhe burimet ekzistuese

Puna afruese


- Është kryer programi i punës afruese nga tetori deri në dhjetor, ku pati më shumë se 400 angazhime në 33 vende, pjesëmarrje në më shumë se 20 aktivitete publike të organizuara nga palë të treta dhe organizim të uebinarëve që tërhoqën interesin e më shumë se 3.000 subjekteve të regjistruara
- Pas kësaj pune afruese, Fondacioni mori 576 letra me komente nga një largmi organizatash dhe individësh nga mbarë bota. Administratorët e besuar dëshirojnë të falënderojnë të gjithë ata që morën pjesë në këto aktivitete dhe që dërguan përgjigje
- Të gjitha përgjigjet ndaj materialit të konsultimit i gjeni në faqen në internet të Fondacionit të SNRF-ve

Zbërthimi i përgjigjeve

Breakdown of respondents by Region



Breakdown of respondents by Category



Konsultimi për raportimin e qëndrueshmërisë

- Takimi i administratorëve të besuar më 1 shkurt për të shqyrtuar fazën e parë të analizës
- Administratorët e besuar njohën mbështetjen e gjerë për standarde globale të qëndrueshmërisë dhe për krijimin e Bordit të Standardeve të Qëndrueshmërisë pranë Fondacionit të SNRF-ve
- Kryerje e analizës së mëtejshme për të vlerësuar kushtet e shprehura nga dërguesit e komenteve së bashku me mbështetjen e tyre

Konsultimi për raportimin e qëndrueshmërisë

- Deklarata e administratorëve të besuar në muajin shkurt:

Përgjigjet tregojnë kërkesën urgjente në rritje për ta përmirësuar njëtrajtshmërinë dhe krahasueshmërinë globale të raportimit të qëndrueshmërisë, si edhe vlerësimin se lipsen marrë hapa të ngutshëm, krahas kërkesës së gjerë që Fondacioni i SNRF-ve të luajë një rol në këtë.

Në bazë të kësaj kërkesë, administratorët e besuar kanë rënë dakord të ndërmarrin analizë të hollësishme të mëtejshme të vërejtjeve dhe sugjerimeve lidhur me kriteret për suksesin dhe për kushtet e tjera që duhen përmbushur përpara se të mendohet ngritja e një bordi të ri. Administratorët e besuar miratuan formimi e një komiteti drejtues të administratorëve të besuar për të mbikëqyrur fazat e ardhshme të punës dhe shtuan një kriter kyç suksesi: nevoja për realizim të shpejtë të standardeve globale, sidomos për klimën.

Mbledhja e administratorëve të besuar në muajin mars

- Administratorët e besuar të Fondacionit të SNRF-ve u takuan më 2-4 mars 2021 për të vijuar analizën dhe diskutimet mbi vërejtjet dhe sugjerimet e marra në përgjigje të materialit të konsultimit për raportimin e qëndrueshmërisë
- Midis mbledhjeve të muajit shkurt dhe mars, IOSCO nxori një deklaratë publike ku shpallte synimin e IOSCO-s për të punuar me Fondacionin e SNRF-ve për ngritjen e një bordi të ri për vendosjen e standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë në përmbushje të nevojave të tregjeve të kapitalit. Kjo do të përfshijë edhe mbështetjen e bordit të ri dhe të standardeve të tij

Deklarata e administratorëve të besuar në muajin mars:

- *Mbështetur në vërejtjet dhe sugjerimet e marra në konsultimet e vitit 2020 dhe të nxitur nga deklarata e Bordit të IOSCO-s, administratorët e besuar kanë arritur në këto pikëpamje lidhur me drejtimin strategjik të një bordi të ri:*
 - **Fokusi te investitorët për vlerën e ndërmarrjes:** bordi i ri do të fokusohet te informacionet që janë me rëndësi për vendimet e investitorëve, huadhënësve dhe kreditorëve të tjerë
 - **Objekti i qëndrueshmërisë me përparësi klimën:** për shkak të nevojës së ngutshme për informacion më të mirë për çështjet e lidhura me klimën, bordi i ri do të fokusonte fillimisht punën te raportimi i lidhur me klimën, duke punuar ndërkohë në drejtim të përmbushjes së nevojat për informim të investitorëve për çështjet e tjera mjedisore, sociale dhe qeverisëse (MSQ)
 - **Mbështetja në kornizat ekzistuese:** Bordi i ri do të mbështetej në punën e afirmuar të Task-Forcës për Dhënie e Informacioneve Financiare të Lidhura me Klimën (TCFD) të Bordit të Stabilitetit Financiar, si edhe në punën e bërë nga aleanca e organeve të vendosjes së standardeve në raportimin financiar me fokus vlerën e ndërmarrjes. Administratorët e besuar do të shqyrtojnë prototipin e propozuar nga aleanca për një qasje ndaj dhënies së informacioneve shpjeguese të lidhura me klimën si një bazë e mundshme mbi të cilën bordi i ri të hartojë standardet e raportimit të lidhura me klimën. Për t'u përgatitur për këtë punë, Fondacioni i SNRF-ve do të nisë procesin e angazhimit të strukturuar me organizatat përkatëse
 - **Qasja me shtylla mbështetëse:** duke punuar me organet e vendosjes së standardeve nga vendet më kryesore, standardet e nxjerra nga bordi i ri do të ofronin një pikënisje të raportimit të qëndrueshmërisë të njëjtë dhe të krahasueshme në nivel botëror, duke ofruar në të njëjtën kohë fleksibilitetin për bashkërendim mbi kërkesat e raportimit që mbulojnë efektet e gjera të qëndrueshmërisë

Hapat në vijim

- Administratorët e besuar synojnë të publikojnë
 - një pasqyrë të vërejtjeve dhe sugjerimeve ku të jepen në formë të përmbledhur përgjigjet e ardhura për konsultimin e vitit 2020 dhe
 - për komente publike ndryshimet e propozuara për t'u bërë në Kushtetutën e Fondacionit, që janë të nevojshme për të zyrtarizuar krijimin e bordit të ri (çdo ndryshim i Kushtetutës është objekt konsultimi publik me periudhë 90-ditore për komente)
- Administratorët e besuar do të vijojnë angazhimin me Bordin e Monitorimit dhe do të informohen për pikëpamjet mbi ndryshimet e propozuara
- Administratorët e besuar janë në proces të marrjes së një vendimi për një bord të ri përpara konferencës së OKB-së për ndryshimin klimatik të muajit nëntor 2021

Na gjeni në internet



www.ifrs.org



IFRS Foundation | International Accounting Standards Board



@IFRSFoundation



IFRS Foundation



IFRS Foundation

Join our team: go.ifrs.org/careers